



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET SKËNDAJ
ADRESA Rr."Reshit ÇOLLAKU",
Pall."SHALLVARE", Nr.09, Tirane.
TEL: 0672027200



VERTETIM NENSHKRIMI

(STATUTI)

Nr. repertori: 1751

Tirane më 02/04/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021053980124840220

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ALKET SKËNDAJ**



V2021053980124840220

DATE 02/04/2021
NR REP 1751

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 02.04.2021, para meje Noter ALKET SKËNDAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rr."Reshit ÇOLLAKU", Pall."SHALLVARE", Nr.09, Tirane., u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Agron Hafizi, atësia Xhevdet, amësia Lirije, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Himë Kolli; Nd. 43; H. 6; Ap. 27; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 19/07/1962, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036033433 dhe nr. personal G20719027K, .

NËNSHKRUES/IT:

VELIMIR CONGRADAC, atësia DANILO, shtetas Serb, lindur në NOVI SAD, me adresë Novi Sad, lindur më 21/02/1973, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 012270119 dhe nr. personal 2102973820014, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit ne Statut i Shoqërisë Tregtare "ION SOLUTIONS" SHPK, bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
ALKET SKËNDAJ

Sot me datë 02.04.2021 (dymijenezetenje), para meje Noter Publik Alket B. SKENDAJ me Seli: Rr."Reshit COLLAKU", Pall."SHALLVARE", Nr.09, Tirane, u paraqiten personalisht dhe me kerkuan perpilimin e kesit Statuti, si me poshte:

STATUTI I
SHOQERISE TREGTARE
"ION SOLUTIONS" SH.P.K.

KREU 1

DIZPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Sipas kerkesave te ligji nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe atij nr 9723, date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", krijohet shoqeria tregtare "ION Solutions" Sh.p.k , e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statuti.

NENI 2

Ne kete statut termat e meposhtme kane keto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ION Solutions" Shpk
Shoqeria: Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ION Solutions" Shpk
Ligji Tregtar: Ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

Në kuptim të këtij Statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vetor "ai" përfshin edhe përemrin vetor "ajo" dhe përemrin vetor "ate", nënkuptohen të dyja gjinitë me përjashtim të rasteve kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit të shoqerisë.

KREU 2

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI 3

Sot, me 02.04.2021, ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin ION Solutions Sh.p.k.

Themeluesit e shoqerie "ION Solutions" Shpk jane:.

- Z. Agron Xhevdet HAFIZI, i datelindjes 19.07.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me Nr.Personal G20719027K.
- Z. Velimir Danilo CONGRADAC, i datelindjes 21.02.1973, lindur ne Novi Sad dhe banues ne Novi Sad, Serbi, shtetas serb, me Nr.Personal 2102973820014.

NENI 4

Shoqeria do te kete statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

1. Instalimi te pajisjeve e sistemeve te automatizimit, elektrike, IT, Alarmeve Elektronike, televizive, etj
2. Tregetimi i pajisjeve e sistemeve te automatizimit, elektrike, IT, Alarmeve Elektronike, televizive, etj



3. Cdo aktivitet tjeter qe lidhet me objektet e mesiperm, kryerjen e sherbimeve perkatese ne lidhje me to.

NENI 6

Shoqeria e ka seline e saj ne: Rruga ne krah te Coca-Colas, Autostrada TR-DR km.5, prane shinave te trenit, brenda objektit me Nr.17, Tirane.

Ajo mund te cele dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise si dhe jashte saj.

NENI 7

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

NENI 8

Shoqeria do te kete vulen e saj.

KREU 3

KAPITALI

NENI 9

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 2.000,00 (Dymije) Euro dhe perbehet nga 2 kuota. Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- Z. Agron Xhevdet HAFIZI, i datelindjes 19.07.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, Shqiperi, shtetas shqiptar, me Nr.Personal G20719027K, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1.000,00 (njemije) Euro qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Z. Velimir Danilo CONGRADAC, i datelindjes 21.02.1973, lindur ne Novi Sad dhe banues ne Novi Sad, Serbi, shtetas serb, me Nr.Personal 2102973820014, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1.000,00 (njemije) Euro qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar do te shlyhet me afat deri ne 1 vjet. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

NENI 10

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

NENI 11

Ortaku mund te transferoje te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Transferimi i kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

KREU 4

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 12

Organet te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

NENI 13

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

NENI 14

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shperndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 15

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperm te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

NENI 16

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.



Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 17

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat (¾) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) ndryshimin e statutit,
- b) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) shperndarjen e fitimeve,
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve
 - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - e) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

ADMINISTRIMI

NENI 18

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte ripërteritjeje. Emerimi i administratorëve prodhën efekte pas regjistrimit ne QKB.

NENI 19

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne maredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 5 te ketij statuti.

Organi Administrativ (administratori) ka te drejte dhe duhet te:

- a) kryeje me mirebesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakeve e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi;
- b) përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajnë pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryeje regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryeje detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

f) marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e maredhenieve te punes me ta.

g) perfaqesoje apo emeroje perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria ose ne ceshtje te tjera me pale te treta;

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pervec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

NENI 20

Administrator i Shoqerise "ION Solutions" emerohet Z. Idlir Sali FRANGU i datelindjes 16.08.1989, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, Shqiperi, me Nr.Personal I90816061K. Afati i mandatit te administratorit do te jete 5 vjet nga data e miratimit te ketij statuti.

KREU 5

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 21

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi; mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, etj.

NENI 22

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e pergjithshme e Ortakeve.

NENI 23

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti financiar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 24

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodi I Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqiptare.

KREU 6

DIZPOZITA TE VECANTA

PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 25

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) ipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) me vendim te gjykates;

NENI 26

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

NENI 27

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

BAZA LIGJORE

NENI 28

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

NENI 29

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

NENI 30

Ky statut u perpilua ne prani te ortakeve te shoqerise duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire.

Akti hartohet ne prani te perkthyeses se njohur nga Ministria e Drejtesise Znj. Jonida TATAZI.

Statuti u perpilua ne 4 kopje me vlere te njejte ligjore, iu lexua Paleve te interesuara me ze te larte, te qarte, kuptohet, mbasi u gjet e perpiluar ne perputhje me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe me Ligjin, u nenshkrua rregullisht ne prezencen time, me pas une Noteri Publik vertetoj nenshkrimet e tyre sipas kompetencave qe me jep Ligji Nr.110 date 20.12.2018 "Per Noterine".

ORTAKET E SHOQERISE **"ION Solutions" SHPK**

Agron Xhevdet HAFIZI



Velimir Danilo CONGRADAC



NOTER
Alket B. SKENDAJ

